



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2446

Nr. _____ Prot

0807

Peshkopi, më _____.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 23

Datë: 02.07.2025 , si dhe projekt-vendimin Nr.1840prot.

“Për rimiratimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Dibër”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





2946/09.07.25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.568/1 prot.

Peshkopi, më 09.07.2025

Lënda: Për vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË


DIBËR


Në mbështetje të nenit 16-të të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr.23 (njëzetetre) datë 02.07.2025, të Këshillit të Bashkisë Dibër, "Për rimiratimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile", **vendosa :**

Miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës përkatëse.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.

PREFEKTI
Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM


Nr. 23 Datë 02/07/2025

“Për rimirimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Dibër”

Në mbështetje të ligjit nr.139.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 , pika 1,2 germa a dhe c, neni 24, pika 2, ligjit nr.107 datë 22.10.2016 “Për prefektin e Qarkut”, ligjit nr.45 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 14, pika 1,2,3,6, VKM 923 date 25.11.2020” Per funksionimin e organizimin e Komitetit të mbrojtjes Civile dhe bashkepunimin nderinstitucional te Institucioneve dhe te strukturave te sistemit te Mbrojtjes Civile”, neni 15, VKM nr.807 date 15.12.2023”Për miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile”, si dhe urdherit të Kryetart të Bashkisë Dibër nr.10 date 15.01.2025”Per ngritjen e nje grup pune për hartimin e dokumentit të Emergjencave Civile në nivel Bashkie”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 02.07.2025, me 20 vota pro, 0 kundër dhe 2 apstenim:

VENDOSI:

1. Të rimiratoj dokumentin e Planit Vendor të Mbrojtjes Civile të Bashkisë Dibër.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
3. Vendimi u shpall me datë 29.01.2025.



Kupja
03-07-2025
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBER
DREJTORIA PPECK**

Nr. 1840 prot.

Peshkopi, më 22. 05. 2025

PROJEKT – VENDIM

“ Për rimiratimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Dibër ”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1, 2, gërma a dhe c, neni 24, pika 2, Ligjit nr. 107 datë 22. 10. 2026 “ Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, neni 14, pika 1, 2, 3, 6, VKM nr. 923 datë 25, 11, 2020 “ Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të Institucioneve dhe të strukturave të sistemit të Mbrojtjes Civile”, neni 15, VKM nr. 807 datë 15. 12. 2023 “ Për Miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile”, si dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Dibër nr. 10 datë 15. 01. 2025 “ Për ringritje grup pune për hartimin e dokumentit të Emergjencave Civile në nivel Bashkie”, i propozojmë Këshillit Bashkiak Dibër në mbledhjen e tij si më poshtë vijon :

- I. Të rimiratojë dokumentin e Planit Vendor të Mbrojtjes Civile të Bashkisë Dibër.
- II. Rishikimi i Planit Vendor të Emergjencave Civile i Bashkisë Dibër, ka si qëllim ripërcaktimin e masave dhe aktiviteteve për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.
- III. Pas miratimit të planit të bëhet shpërndarja e tij sipas përcaktimeve ligjore të nenit 8 dhe të nenit 14 të ligjit nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

PËR BASHKINË DIBËR

DREJTORIA PPECK

Hazbi KAMBERI

KRYETARI KOMISIONIT

Ramazan TEMA

DREJTORIA JURIDIKE

Ismet SARAÇI

KRYETARI BASHKISË DIBËR

Rahim SPAHIU





REPUBLICA ESHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

RELACION

Dibër,më. / 05 / 2025

“ PËR RIMIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR EMERGJENCAT CIVILE NË BASHKINË DIBËR “

KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

Të nderuar këshilltarë.

Në mbështetje të ligjit Nr.139 / 2015,” Për Vetëqeverisjen Vendore “,nenit 14,nenit 30, pika “ ç “ të Ligjit Nr.45 / 2019 “ për mbrojtjen Civile “.

Ju informojmë :

Dokumenti I Planit Vendor të Emergjencave Civile përkhruan punën e bërë në detyrimet që rrjedhin në nivel lokal bazuar ne ligjin nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile”.

Plani për emergjencat civile është plani për përgatitjen,parandalimin,mbrojtjen,shpëtimin dhe ndihmën në rast të një fatkeqësie natyrore ose të njëfatkeqësie tjetër,I hartuar në bazë të vlersimit të risqeve dhe të gjetjevetë ekprteve.

Çdo njësi e vetë qeverisjes vendore,me vendim të këshillit bashkiak,hartojnë,përditësojnë dhe miratojnë minimalisht jo më pak se njëherë në çdotre vjet planin vendor për emergjencat civile.

Plani vendor për emergjencat civile është miratuar në këshillin bashkiak në vitin 2023,por sipas VKM Nr.807 datë. 28.12.2023 ” Për miratimin e PVEC” u kthye për rishikim.

Plani vendor I emergjencave civile për bashkinë Dibër është I harmonizuar me Planin kombëtar për Emergjencat,I miratuar me VKM Nr.807,datë 28.12.2023 dhe metotologjisë për hartimin e planeve për emergjencat civile,sipas modulit të trajnimeve baze të mbrojtjes civile për strukturat civile në nivel Bashie gjate vitit 2024 dhe ajo e fondit e zhvilluar me datat 02,03 dhe 04 Prill 2025 mbi “ Rritjen e kapaciteteve të pushtetit vendor në vlersimin dhe menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë në Qarkun Dibër.

Ky material është përgatitur duke ndjekur këto hapa:

Hapi I parë

Formimi I grupit të punës në bashkinë Dibër,për hartimin e Planit Vendorë për Emergjencat civile.

Si pjesë përgatitore u zhvillua takimi me Kryetarin e Bashkisë Dibër,si dhe me stafin teknik për hartimin e dokumentit,me urdhër nr.10 datë.15.01.2025 u ngritë grupi I punës me përfaqësues nga Drejtoria e Financës,Drejtoria e P.ZH.M.T,Drejtoria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural,Drejtoria e pyjeve,Parqeve dhe Rekreacionit,Bordi I kullimit,Drejtorisë së M.Z.SH-së,Drejtoria e Mbrojtjes Civile.Në zbatim të urdhërit të Kryetarit Bashkisë,u përgatit programi I punës për përditësimin e këtij plani.

Duke ju referuar dhe shkresës me nr.453,datë 24.01.2024 nga Agjencia Komëtare e Mbrojtjes Civile,me urdher nr.470,datë.02.09.2024 u ngrit sekretariat Teknik për procesin e hartimit të dokumentit të Planit Vendor të Emergjencave Civile.

Hapi I dytë:

Njohja dhe vlersimi I situatës.

*Identifikimi I rreziqeve që prekin territorin nën administrim.

Rreziqet më kritike që kanë një potencial të lartë negative në territorin e Bashkisë Dibër janë:

• Zjarret massive
• Rreshjet e dëborës
• Përmbytjet
• Rrëshqitjet e tokës
• Tërmetet
• Çarjet e digave
• Biologjike
• Teknologjike (të shkaktuara nga njeriu / proceset

Me VKM Nr.113 datë 31.10.2023 është miratuar Vlersimi I Riskut nga Fatkeqësitë.Dokument që është dërguar në Istitucionin e Prefektit dhe AKMC, për qëllime analizimi dhe planifikimi.

Hapi I tretë:

Vendosja qëllimeve dhe objektivave.

- **Përcaktimi I qëllimeve.**

Plani Vendor për Emergjencat Civile synon të:

- 1- Ndhimjohë parandalimin,lehtësimin,përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga çdo ndikim negative si pasojë e emergjencave dhe/ose fatkeqësive që mund të prekin jetën e njerëzve,gjënë e gjallë,pronën,trashëgimninë kulturore,komunitetet dhe mjedisin.
- 2- Sigurojë kushtet për administratat publike,subjektet ekonomike dhe popullsisë për të kaluar nga kushtet normale të jetesës dhe punës në një situatë emergjente,me humbje minimale.
- 3- Mundesojë ofrimin e burimeve shtetërore me qëllim garantimin e sigurisë publike dhe vazhdimësinë e ekonomisë vendore.

• **Pëcaktimi I objektivave:**

- 1- Harmonizimi me praktikat më të mira vendore,rajonale,ndërkombëtare.
- 2- Dhënia e informacioneve mbështetëse për të gjitha grupet e interesit me qëllim përdorimin e teknologjisë,për kufizimet dhe kapacitetet e përbashkëta.
- 3- Përgatitja e një plani actual dhe realist,I cili të jetë I përshtatshëm për të gjitha grupet e interesit me një fokus të veçantë tek tek grupet më të cënueshme.
- 4- Përgatitja e një plani që do të ofrojë informacione për zvoglimin e riskut të rreziqeve dhe mbrojtjen e popullsisë së cënueshme.
- 5- Prezantimi I procedurave dhe informacioneve me qëllim koordinimin e burimeve në mënyrë të sigurt,efektive dhe efikase gjatë përgjigjes ndaj emergjencave.
- 6- Kalimi në fazën e rimëkëmbjes pas emergjencave dhe dhënia e ndihmës për vazhdimësinë e veprimtarisë së qeverisjes vendore në mënyrë sa më efektive,efikase dhe sa më afër qytetarëve,bisnesit dhe shërbimeve.

Hapi I katërt:

- Zhvillimi I Planit të Emergjencave Civile.
- Përcaktimi I procedurave për hartimin PEC dhe identifikimi i aftësive.

Grupi I punës I ngritur me urdhër të Kryetarit të bashkisë:

- U njoh me VKM nr.807,datë 28.12.2023," Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile"
- U bënë vizita dhe vëzhgime të drejtpërdrejta në terren
- U bënë takime,intervista me qytetarët,bisneset.
- Takime pune të grupit.
- Përsa I përketë identifikimit të aftësive,nga grupi I punës do të veçonim:
- **Aftësinë teknike** të grupit,të cilët në nivel specialist dhe drejtuesi kanë njohuri të veçanta në fushat që mbulojnë si dhe në sistemin e informacionit.

- **Aftësia në mardhëniet me njerëzit**,ka të bëjë me të kuptuarit,motivimin si dhe udhëheqjen e personelit.
- **Aftësia konceptuale**,ka të bëjë me të kuptuar informacionin për të dhënë direktiva,për të bërë përgjithësime.
- Identifikimi i nevojave për informacio,mbledhja dhe përpunimi i tij.

Burimet për informacion të cilat janë përdorur në këtë dokument kanë qenë të besueshme dhe zyrtare.Informacioni i është referuar informacionit zyrtar të institucioneve si dhe bazës së të dhënave të humbjes nga fatkeqësitë në bashkinë Dibër.Ky informacion i grumbulluar është i organizuar në mënyrë sistematike në lidhje me fatkeqësitë,dëmet,humbjet dhe impaktet.

Hapi I pestë:

- Përgatija,kontrolli për përputhshmërinë ligjore dhe miratimi i PEC:
- Hartimi i Planit Vendor të Emergjencave Civile.

Së pari, u bë shkrimi i draftit paraprak,qarkullimi i këtij materiali në grupin teknik.

Së dyti,në procesin e komunikimit,të kalimit të informacionit,nëpërmjet takimeve në tryeza pune,por dhe në të gjitha kanalet,u tërhoq mendimi i punonjësve të tjerët të institucioneve duke realizuar dokumentin e avancuar.

Së treti,përsa i përket kontrollit të përputhshmërisë ligjore kjo është realizuar nëpërmjet monitorimit të procesit të punës për aritjen e objektivit.Ky monitorim është realizuar me mjetet e komunikimit në formën shkresore,por dhe të raportimit javor të punës tek kabineti i Kryetarit,Sekretari i Përgjithshëm.

- Miratimi i PVEC institucione.

Në ligjin nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile”,është përcaktuar se plani Vendor për Emergjencat Civile miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak.

Me konfirmimin e bazueshmërisë ligjore nga institucioni i Prefektit,plani vendor i emergjencave civile do ti dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Prefektit të Qarkut për qëllime analizimi dhe planifikimi.

Hapi I gjashtë.

Implementimi ,mirmbajtja,rishikimi,përditësimi i PVEC.

➤ Testimi I PVEC.

Plani Vendor I Emergjencave Civile është plani për përgatitjen, parandalimin, mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të një fatkeqësie natyrore ose të një fatkeqësi tjetër, hartuar në bazë të vlersimit të risqeve.

Përsa i përket testimit të planit, për menaxhimin e fatkeqësive, do të zbatohen masa të përgatitjes, përgjigjes ndaj fatkeqësive dhe të rimëkëmbjes prej tyre të përcaktuara në strukturat, në rolet dhe përgjegjësitë që ato kanë.

➤ Rishikimi, Përditësim dhe Mirmbajtja e PEC.

Rishikimi, përditësimi dhe mirmbajtja e planit do të bëhet duke ju referuar kuadrit ligjor të përcaktuar si dhe gjatë përballjes me fatkeqësitë natyrore që mund të prekin territorin e bashkisë Dibër.

Për të gjitha arsyet e trajtuara më sipër propozojmë :

- 1- Miratimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile për bashkinë Dibër.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

Grupi I punës:

- | | |
|----------------------------------|----------------|
| - Specialisti I Drejtorisë PPECK | Ramazan TEMA |
| - Specialisti I Drejtorisë PPECK | Ilir KACNIA |
| - Specialisti I Drejtorisë PPECK | Mario SELISHTA |

Kryetar

Anëtar

Anëtar



K R Y E T A R I I B A S H K I S Ë

Rahim SPAHIU

